

## NOUN TERMS OR TERMS WITH A NOUN AS A BASE, ADJECTIVE AND VERBAL TERMS IN THEORETICAL MECHANICS IN ALBANIAN AND ENGLISH

Prof. ass. Dr. Sadete Pllana<sup>1</sup>, Mr. sc. Gani Pllana, PhD Student<sup>2</sup>

<sup>1</sup>University of Prishtina, Faculty of Economics – E-mail: [sadetepllana@hotmail.com](mailto:sadetepllana@hotmail.com)

<sup>2</sup>Vienna University of Technology – E-mail: [gani\\_pllana@hotmail.com](mailto:gani_pllana@hotmail.com)

Received: 2012-10-01 Accepted: 2012-10-07 Published: 2012-11-01

### Abstract

Adjectives formed with compositions have more of an interest to be studied in the Albanian language, in the composition of which are the words një (one), dy (two), tre (three), shumë (many) in concurrence with other nouns and with the suffixes –(ë)she-e, –ë(s) -e. In English, these compounds are limited and a part of English pronoun compounds will appear as mainly borrowed, meaning, without the disintegrating word forming elements, like: stellar, angular, radial. Compound constructions in Albanian like yllëzor, këndor, rrezor respond to these formations. Verbal formations in both languages are very limited. The ones that raise an interest are the formations with the English conversion which present difficulty in the finding of the equivalence in Albanian. In most cases they need to be treated in an individual manner by connecting them in the system with the producing theme like shaft and (to) shaft, belt and (to) belt, thread and (to) thread.

**Keywords:** term, adjectives, verbal terms, terminology, theoretical mechanics.

### Hyrje

Në terminologji për termin ka përkufizime të ndryshme. Disa autorë termin e përkufizojnë si a) njësi të sistemit terminologjik për emërtimin e nocioneve, b) pjesë e një sistemi të caktuar për emërtimin e nocioneve në sistemin e nocioneve të një fushe dije ose të një fushe të caktuar prodhimi<sup>22</sup>. Termi si njësi leksikore nga ana strukturore paraqitet edhe në formën e fjalës, pra, nga forma është edhe fjalë dhe, si çdo fjalë, e ka kuptimin si anë qenësore të vetën. Kuptimi i termit është aftësia e tij për të shprehur konceptin. Në rast se termi paraqitet në formën e togfjalëshit, s'mund të flitet më për kuptim të termit, por për koncept të tij<sup>23</sup>. Kështu, p.sh., mund të krahasohen termi *rrënjë* (mek.) si term fjalë dhe *rrënjë dhëmbi* po në (mek.) si term togfjalësh. Në rastin e parë mund të flasim për kuptimin e termit *rrënjë* (mek.), sigurisht duke nënkuptuar me këtë edhe konceptin, kurse, në rastin e dytë, njësia e pathjeshtë leksikore *rrënjë dhëmbi* si term shpreh vetëm koncept; të dy elementet përbërëse të saj si fjalë të veçanta, *rrënjë* dhe *dhëmbi* mund të cilësohen si dy elemente të termit që shprehin dy koncepte të ndryshme e që në tërësinë e tyre përbëjnë një koncept rezultante të vetëm "*rrënjë dhëmbi*"<sup>24</sup>. Lidhjet fjalë-term kushtëzojnë disa tipare të përbashkëta të fjalës me termin, të cilat në terminologji mund të shihen si defekte të saj, siç mund të jenë polisemia dhe sinonimia. Megjithatë, ky aspekt gjuhësor i përket terminologjisë së përgjithshme, sepse në terminologjitë e fushave të veçanta të dijes termi futet në rrethin e sistemit terminologjik, brenda të cilit dukuritë e mësipërme nuk gjejnë vend. Kështu, p.sh. mund të përmenden *rrënjë*, *shtypje*, *tension*, si terma të përgjithshëm, që kanë një volum nocionor të gjerë, dhe po këta terma të përdorur në fusha të ndryshme dije, si në mekanikën teorike, mekanikën e zbatuar në makina, në matematikë, fizikë etj.

<sup>22</sup> H. Pasho, "Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në vitet '80 të shek. XX", ASHSH, Tiranë, 2005, f. 10.

(Autorja thekson se "veçoria e termit që emërton një nocion me kufij kuptimorë të përcaktuar kushtëzon një formë të brendshme të qartë, mundësisht të motivuar në një shkallë sa më të lartë" (fq. 94)

<sup>23</sup> A. Duro, "Termi dhe fjala në gjuhën shqipe", Tiranë, 2009, f. 37.

<sup>24</sup> Po aty, f. 37.



**c) Raste tjera që mund të takohen ose të modeluara (si raste potenciale)**

1. fjalë e huaj – fjalë e huaj / fjalë e huaj – fjalë e huaj  
 \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_

2. togfjalësh i huaj – togfjalësh i huaj / togfjalësh i huaj – togfjalësh i huaj  
 \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_

3. togfjalësh i huaj – togfjalësh shqip / me elemente të përziera  
 \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_

4. fjalë shqipe – togfjalësh i huaj / fjalë angleze – togfjalësh i huaj  
 \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_

**Terma mbiemra**

**Në shqipe**

**Në anglishte**

(pa barasvlerës kuptimor)

**1. fjalë shqip-fjalë shqip**

*bërrylor – gjunjor /*

*bartës-e – tejbartës-e /*

**2. fjalë e huaj – fjalë shqip**

*rapid – shpejtprerës /*

*translativ – tejbartës /*

*avancues – përparues /*

*dentated – \_\_\_\_\_*

*stellar – \_\_\_\_\_*

*spatial(angular) – \_\_\_\_\_*

**3. fjalë e huaj – fjalë hibride**

*aksial – aksor /*

*spherical – \_\_\_\_\_*

**4. fjalë e huaj – fjalë e huaj**

\_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_

**5. në nivel fjalëformues**

*i dhëmbëzuar – dhëmbëzor-e /*

*shumështresësh – shumështrësor /*

*i shumanshëm – shumanësor /*

*dentated – \_\_\_\_\_*

*multilayer – \_\_\_\_\_*

*multilateral – \_\_\_\_\_*

## Terma folje

## Në shqipe

## Në anglishte

(pa ose me barasvlerës kuptimor)

## 1. fjalë shqipe-fjalë shqipe e huaj

*ndërdhëmbëzohet – ngërthehet / (to) mesh – (to) engage*

## 2. fjalë shqipe - fjalë e huaj

*ngërthehet – ingranohet /**rrotullohet – xhiron /**zhvendoset – spostohet /*

_____	-	_____
_____	-	_____
_____	-	_____

## Përfundim

Termi kryesisht funksionon si emërtim emëror, e shpesh mund të dalë edhe në pjesët tjera të ligjëratës, si *mbiemër*, si *folje*, e ndonjëherë edhe si *ndajfolje*. Nga njëra anë fjala si *fjalë-folje* ka një strukturë kuptimore më të gjerë se *fjala-emër* (p.sh. pres-ka 25 kuptime, prerje-ka 6 kuptime, punoj-ka 20 kuptime, punim-ka 5 kuptime, sipas Fj. 1980), nga ana tjetër termi si *term-emër* ka një strukturë më të gjerë kuptimore se sa *termi-folje* (pres-vetëm si proces i prerjes dhe prerje). Shpesh janë shprehur mendime të ndryshme lidhur me funksionimin e termit në rolin e pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Disa terminologë janë mendimit se termi mund të paraqitet në rolin e pjesëve shënjuese të ligjëratës: *të emrit, të mbiemrit, të foljes, të ndajfoljes*; kurse disa terminologë tjerë i përmbahen pikëpamjes se si terma duhen konsideruar vetëm *emërtimet emërore*. Zgjidhja e drejtë e këtij problemi ka rëndësi të madhe gjatë hartimit të fjalorëve terminologjikë.

## Referencat

- [1] Beer, F. ; etj. (2004): “*Vector Mechanics for Engineers Statics*”, McGraw-Hill, New York, 2004.
- [2] Buckch, H. (1976): “*Getriebewörterbuch- Dictionary of mechanisms*”, Bauverlag GmbH-Wiesbaden und Berlin, 1976.
- [3] Duro, A. (1983): “*Sistemet terminologjiek dhe dysorët terminologjikë në rrafshin e fjalëformimit të gjuhës shqipe të përqsur edhe me italishten, anglishten dhe rusishten*”disertacion, Tiranë, 1983.
- [4] Duro, A. (2009): “*Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*”, Tiranë, 2009.
- [5] “*Fjalor i gjuhës shqipe*”, Tiranë, 1980.
- [6] “*Fjalor i termave themelorë të mekanikës*”, Tiranë, 2002.
- [7] Gaçe, Th. (1973): “*Mekanika teorike I*, Tiranë, 1975.
- [8] *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I* (1995), ASHSH, Tiranë, 1995.
- [9] Jagxhiu, F. (1976): “*Mekanika pjesa I Statika*”, Prishtinë, 1976.
- [10] Kurti, S.; etj. (1991): “*Fjalor politeknik anglisht-shqip*”, Tiranë, 1991.
- [11] Leka, F. (1983): “*Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore*”, Tiranë 1983.

- [12] Norton, L. R. (2004): "Design of Machinery", McGraw-Hill, New York, 2004.
- [13] Olldashi, Dh. (1983): "Fjalor politeknik frëngjisht-shqip", Tiranë, 1983.
- [14] Piht, H. (1985): "Terminology: An Introduction", Kopenhagen, 1985.
- [15] Sager, J. (1990): "A practical course in terminology processing". Amsterdam, 1990.
- [16] Pllana, G.; Pllana, S. (2012): "A conceptual connections on a word and term level in the terminology of Theoretical Mechanics (in Albanian and English)", *trans&MOTOAUTO'12 20<sup>th</sup> International scientific and technical Conference on transport, road-building, agricultural, hoisting & hauling and military technics and technologies 27.-29.06.2012*, p. 3-4, ISSN 1313-0226 Varna, Bullgari, Varna, 2012.
- [17] Pllana, S.; Pllana, G. (2012): "*Rruga semantike e ndërtimit të terminologjisë së mekanikës teorike në shqip dhe anglisht*", International Conference CHALLENGES TO STUDIES IN ENGLISH LANGUAGE, 1-2 qershor 2012, Universiteti i Tiranës, FGJH Departamenti i gjuhës angleze, Tiranë, 2012.
- [18] Pllana, S.; Pllana, G. (2012): "*Marrëdhëniet e leksikut terminologjik dhe joterminologjik në lidhje me informacionin shkencor-teknik në fushën e mekanikës teorike*", WISSENSCHAFTLICHE KONFERENZ, Literatur, Landeskunde und Komparatistik, Fremdsprachenfakultät der Universität Tirana, 29. Juni 2012, Tiranë, 2012.
- [19] Pllana, S.; Pllana, G. (2012): "*Njëkuptimësia dhe saktësia në terminologjinë e mekanikës teorike në shqip dhe anglisht*", Seminari i VI-të Ndërkombëtar i Albanologjisë, 20-23 shtatorTetovë/Shkup, USHT Tetovë, 2012.
- [20] Pllana, G.; Pllana, S. (2012): "*Gjendja dhe probleme të zhvillimit të terminologjisë së mekanikës teorike*", Seminari i VI-të Ndërkombëtar i Albanologjisë, 20-23 shtatorTetovë/Shkup, USHT Tetovë, 2012.